

PROGRAMI I
PËRPUETHSHMËRISË
ME
RREGULLAT
E
KONKURRENCËS

Ndërmarrjet ushtrojnë aktivitetin e tyre në një mjedis kompleks ligjor dhe rregullator dhe mirëfunksionimi i aktivitetit të tyre varet edhe nga aftësia që ata kanë për të kontrolluar dhe shmangur shkeljen e këtyre rregullave. Për këtë arsye shumë ndërmarrje kanë investuar dhe kanë marrë masa për parandalimin e shkeljeve të rregullave lidhur me korrupsionin, mashtrimet financiare, sigurinë publike, mbrojtjen e shëndetit dhe mjedisit, etj. Autoriteti i Konkurrencës nëpërmjet këtij materiali i mundëson biznesit shqiptar që të veprojnë lidhur me përpuethshmërinë me rregullat dhe parimet e konkurrencës.



Autoriteti i Konkurrencës (AK), si një institucion publik dhe i pavarur në vendimmarrje, synon t'u sigurojë bizneseve që veprojnë në Shqipëri, një mjedis konkurrues dhe krijues. I drejtuar nga Komisioni i Konkurrencës, AK heton praktikant anti-konkurrenciale dhe promovon avokatinë e konkurrencës, pajtueshmërinë me kuadrin ligjor nën juridiksionin e tij¹, shprehimisht me Ligjin nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", i ndryshuar (ligji 9121/2003), si dhe aktet nënligjore të dala të zbatim të tij.

AK, nëpërmjet këtij materiali informues, përforcon mjetet zbatuese dhe mbrojtëse, të përdorura nga institucioni për *promovimin e përpuethshmërisë/pajtueshmërisë*, me synim final: mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg, sigurimin e një mjedisi konkurrues në treg, eficient dhe të hapur.

Ligji 9121/2003 parashikon rregullat e sjelljes se si ndërmarrjet duhet të konkurrojnë në tregjet ku ato ushtrojnë veprimtarinë e tyre. Nga vetë nevoja e arritjes së qëllimit të këtij ligji lind domosdoshmëria (si në çdo normë juridike) e ndëshkimit të sjelljeve të bizneseve, të cilat çenojnë konkurrencën dhe dëmtojnë konsumatorët.

Ligji "Për Mbrojtjen e konkurrencës" zbatohet për të gjithë sektorët e ekonomisë dhe për të gjithë "lojtarët" e tregut, në të gjithë nivelet e bizneseve, përfshirë edhe ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM). Mënyra se si këto biznese, menaxherët drejtues, punonjësit, apo agjentët e tyre sillen, ndërkohë që kryejnë biznes, mund të çojë në shkelje të rregullave të konkurrencës. Kjo e ekspozon ndërmarrjen dhe punonjësit e saj

ndaj gjobave relativisht të rënda, dëmtim i imazhit dhe reputacionit² të saj, nëpërmjet proceseve gjyqësore dhe ekspozimeve mediatike.

Ligji nr.9121/2003 synon të krijojë një mjedis ku tregjet konkurruese dhe me risi, të mund të zhvillohen. Përpuethshmëri do të thotë të bësh "gjënë e duhur".

Sanksionet administrative mund të arrijnë deri në 10% të xhiros vjetore për një shkelje të vetme, ndërsa individëve mund t'u shkatërrohet si reputacioni, ashtu edhe ngritja profesionale.



¹ Ky material nuk është dokument i detyrueshëm ligjor. Ai përmban informacion të përgjithshëm dhe udhëzime për zbatueshmërinë e legjislacionit në fushën e konkurrencës.

² "Krijimi i një reputacioni kërkon 20 vjet dhe shkatërrimi i tij bëhet në vetëm 5 minuta. Nëse mendon për këtë, sigurisht që do t'i bësh

gjërat ndryshe"- "It takes 20 years to build a reputation and five minutes to ruin it. If you think about that, you'll do things differently." —Warren Buffett

Çfarë është Programi i Përpunshmërisë?

Programi i Përpunshmërisë hartohet për të garantuar përpunshmëri të plotë me rregullat mbi konkurrencën në të gjithë veprimtarinë ekonomike të një ndërmarrjeje;

Programet e përpunshmërisë janë mjete që u mundësojnë lojtarëve ekonomikë të tregut shanset, si për shmangien e shkeljeve të të gjitha llojeve, ashtu dhe të aplikimit të rregullave që janë të zbatueshme për veprimtarinë e tyre, duke përfshirë rregullat e konkurrencës.



Në kuadër të Programit të Përpunshmërisë, shoqëria i trajnon punonjësit e saj lidhur me rregullat e konkurrencës dhe i pajis ato me orientime se si të shmangin marrëveshje, apo praktika, të cilat e kufizojnë konkurrencën gjatë kryerjes së veprimtarive të tyre tregtare si dhe gjatë kontakteve me konkurrentët e tjerë.

Disa programe të përpunshmërisë përcaktojnë dhe se çfarë masash duhen marrë, nëse punonjësit e një ndërmarrjeje vërejnë se një marrëveshje, apo praktikë anti-konkurrese, palë e së cilës është vetë ajo, shkel rregullat e konkurrencës.

– **AK** nxit ndërmarrjet në procesin e hartimit të programeve të përpunshmërisë.

– **AK** konsideron se programet e përpunshmërisë, në mënyrë që të jenë efektive, do duhet të plotësojnë dy objektiva:

së pari, të parandalojnë pjesëmarrjen në shkeljen e ligjit të konkurrencës; dhe

së dyti, të sigurojnë mjetet e zbulimit dhe trajtimit të sjelljeve që nuk janë shmangur.

Prandaj, ky program nuk mund të kufizohet vetëm në masa që synojnë ndërgjegjësimin e menaxherëve, mbikqyrësve dhe punonjësve të tjerë ose agentëve për rregullat ekzistuese dhe detyrimin për të zbatuar rregulla të tilla.

Krijimi dhe mbajtja e një kulture të përpunshmërisë është, sigurisht, një pjesë themelore e këtij procesi.

Vlera e programit të përpunshmërisë pasqyrohet si kombinim i dy komponentëve të lartpërmendura **parandaluese dhe korrigjuese**.



Shpallaja e një kulture përputhshmërie

Autoriteti i Konkurrencës në mbështetje të ndërmarrjeve për forcimin e programit të përputhshmërisë.

Autoriteti i Konkurrencës kontrollon zbatimin e rregullave të konkurrencës për të siguruar një konkurrencë efektive në tregun e vendit. AK ka si qëllim që të mbrojë dhe nxisë konkurrencën midis lojtarëve të tregut, si dhe të promovojë një mjedis ekonomik pro-konkurrenës.

Misioni i AK në këtë mënyrë nuk është i kufizuar vetëm në kontrollin e zbatimit të ligjit të konkurrencës por përfshin edhe rëndësinë e instrumenteve të avokatisë së konkurrencës. Kjo është arsyeja pse Autoriteti inkurajon ndërmarrjet që të miratojnë një strategji pro aktive për të parandaluar ose minimizuar rrezikun e shkeljes së rregullave që ndalojnë marrëveshjet anti-konkurrenuese dhe abuzimet me pozitën dominuese.

Autoriteti kryen këtë pjesë të detyrave të tij ndër të tjera duke dhënë sistematikisht mendime dhe rekomandime lidhur me situatën e konkurrencës në treg. AK gjithashtu publikon udhëzime, d.m.th. dokumente që shpjegojnë disa aspekte të procedurave, politikës dhe zbatimit praktik si programi i lehtësimit nga gjobat, udhëzues specifikë etj). Autoriteti inkurajon përpjekjet e bëra nga ndërmarrjet në mënyrë që të përputhen me rregullat e konkurrencës.

“Programi i përputhshmërisë me rregullat e konkurrencës” përshkruan qasjen që ndjek AK për zbatimin e ligjit 9121/2003. Ndër parimet bazë përmendim:

Parimi i Konfidencialitetit nënkupton se AK do të vijojë të ofrojë siguri lidhur me mbrojtjen e informacionit konfidencial për të siguruar integritetin e procesit hetimor dhe të informacioneve të ndjeshme tregtare të ofruara nga palët gjatë këtij procesi;

Parimi i Objektivitetit/drejtësisë nënkupton se AK do të vijojë të jetë objektiv dhe i drejtë në vendimet e tij dhe të përpiqet të gjejë ekuilibrin e duhur midis zbatueshmërisë dhe pajtueshmërisë;

Parimi i Respektimit të afateve kohore nënkupton se AK do të përpiqet të trajtojë çështjet sa më shpejt të jetë e mundur brenda afateve ligjore të përcaktuara në ligjin e saj organik dhe Kodin e Procedurave Administrative;

Parimi i Transparencës nënkupton se AK do të jetë sa më publik dhe transparent brenda kufijve ligjorë.



Kjo broshurë synon të rrisë aksesin dhe informacionin publik në lidhje me misionin dhe aktivitetin e Autoritetit të Konkurrencës. Broshura është informuese dhe nuk përmban këshilla ligjore

Qëllimi i kësaj broshure është të ndihmojë të kuptohet se: si përpuethshmëria me rregullat e konkurrencës mund të jetë një investim fitues për ndërmarrjen tuaj, nëse ju jeni një SME, apo një ndërmarrje shumëkombëshe. Ajo përshkruan disa nga "praktikat më të mira" (best practices) të identifikuar në këtë aspekt dhe sugjeron nisma praktike që mund të ndërmerren, pavarësisht nga madhësia apo karakteristika të tjera të kompanisë.

Programi i Përpuethshmërisë mund të kuptohet më së miri si një sistem instrumentesh, të hartuara për të plotësuar njëri-tjetrin dhe të ndërthurura drejt nxitjes së konkurrencës dhe përpuethshmërisë me aktet. Ky program ka për qëllim të informojë ndërmarrjet, bizneset, studiot ligjore dhe publikun e gjerë se si AK kërkon këto rezultate përmes një sërë instrumentesh të informimit, zbatimit dhe avokimit.

Shumica e bizneseve dhe menaxherëve preferojnë të veprojnë dhe të sillen në përpuethshmëri me këto parime se sa të përfshihen në procedura hetimore sipas dispozitave ligjore.

AK promovon përpuethshmërinë nëpërmjet një tërësie instrumentesh zbatuese dhe avokuese;

Studiot ligjore promovojnë përpuethshmëri duke i ndërgjegjësuar klientët lidhur me detyrimet e tyre sipas ligjit dhe duke i këshilluar ata se si të sillen në pajtueshmëri të plotë;

Komuniteti i biznesit promovon përpuethshmëri duke hartuar dhe duke zbatuar me efektivitet programet e përpuethshmërisë;

Programet e përpuethshmërisë mundësojnë një ndërmarrje të parandalojë shkeljet e rregullave anti-trust.

Një program përpuethshmërie rrit gjasat e zbulimit dhe më pas të rivendosjes së kushteve normale të konkurrencës në treg. Prandaj, për ndërmarrjet që dëshirojnë të veprojnë në mënyrë parandaluese, programe të tilla mund të bëhen një mjet i dobishëm për menaxhimin e riskut.

Pse duhet ndërmarrë kontrolli i rreziqeve në fushën e zbatimit të ligjit të konkurrencës?

Hartimi dhe miratimi i një programi të përpuethshmërisë është një masë mbrojtëse. Para së gjithash, një ndërmarrje që merr këtë hap mbron veten nga **pikëpamja ligjore**: programi i përpuethshmërisë mund të kontribuojë në uljen e rrezikut si pasojë e një ankese të paraqitur nga një konkurrent ose duke u përfshirë në një hetim të iniciuar nga vetë AK. Një program përpuethshmërie gjithashtu mund të ndihmojë në zbulimin dhe vlerësimin e sjelljeve anti-konkurrese që mund të ketë ndodhur brenda ndërmarrjes.

Gjithashtu, është në interesin më të mirë të ndërmarrjes për të zbuluar gabimet e mundshme sa më shpejt të jetë e mundur dhe

për t'i korrigjuar ato në vetvete. Nëse sjellja anti-konkurrese konsiston në një marrëveshje të ndaluar, interesi më i mirë i ndërmarrjes do të ishte në paraqitjen e një aplikimi për lehtësim nga gjocat pranë AK-së, e cila mund t'i japë imunitet të plotë ose të pjesshëm nga vendosja e gjobës. Ndërmarrjet që janë gjobitur bazuar në ligjin e konkurrencës njollosin imazhin e tyre publik dhe humbin partnerë, besimin e klientëve të tyre, të punonjësve, aksionerëve dhe deri besimin e konsumatorit final.

Një strategji proaktive e përpuethshmërisë me ligjin dhe etikën e biznesit mund të rrisë me siguri reputacionin e një ndërmarrjeje dhe ta bëjë atë më tërheqës për publikun. Kjo do të ndikonte për qëllime të rekrutimit dhe për të

rritur besimin e konsumatorëve, si dhe nxitjen e një ndienje të besnikërisë në mesin e të punësuarve.

Pse përpuethshmëria me ligjin e konkurrencës i bën mirë biznesit tuaj?

Ligji i konkurrencës ka efekt gjithëpërfshirës, ai shtrihet mbi këdo që kryen aktivitet ekonomik në treg dhe zbatohet direkt tek çdo ndërmarrje aktive në treg. Kjo nënkupton jo vetëm stafin ekzekutiv, të cilët zgjedhin ta bëjnë këtë për interesa të ndërmarrjes së tyre, por edhe vetë nëpunësit, të cilët kërkojnë udhëzime se si të zbatojnë këto zgjedhje të eprorëve të tyre.

Përgjegjësia primare e përpuethshmërisë me ligjin lidhet drejtpërdrejtë me ata të cilët janë subjekt i një ligji. Rregullat e konkurrencës që zbatohen për ndërmarrjet, janë direkt të zbatueshme.

Një arsye shumë domethënëse pse një ndërmarrje duhet të pajtohet me rregullat e konkurrencës, pavarësisht faktit se në këtë mënyrë ajo respekton rregullat e të bërit biznes me etikë, janë kostot e larta që duhet të përballojë në rastet e mospërpuethshmërisë.

Një strategji aktive përpuethshmërie me ligjin dhe etikën e biznesit mundet me siguri të rrisë reputacionin e një ndërmarrjeje dhe vëmendjen

për qëllime promociionale dhe rekrutuese, rrit motivimin e stafit, dhe krijon deri një ndjenjë krenarie brenda ndërmarrjes. Gjithashtu, trajnimi i stafit lidhur me atë çfarë përbën sjellje të jashtëligjshme është element i rëndësishëm sidomos nëse kjo sjellje ndodh nga ana e konkurrentëve.

Kjo ndihmon në krijimin e një mjedisi konkurrues, mjedis ku secili aktor luan lojën e tij të ndershme. Secila ndërmarrje mund të kontribuojë në këtë aspekt:

- nëpërmjet informimit të AK lidhur me një shkelje të dyshuar për të cilën merr dijeni;
- të aplikojë për imunitet/lehtësim nga gjobat ose reduktim të saj nëse ka qenë pjesë e një shkeljeje të këtyre rregullave;
- të paraqesë një ankesë, nëse mendon se është penalizuar apo ka pësuar dëme si pasojë e një shkeljeje nga ana e ndërmarrjeve të tjera.

Sanksionet Administrative

Sanksionet administrative/gjobat që Komisioni i Konkurrencës vendos mbi ndërmarrjet të cilat shkelin ligjin e konkurrencës janë shumë domethënëse dhe shkojnë deri në 10% të xhiros totale vjetore të vitit të kaluar financiar të një ndërmarrjeje.

Një gjobë mund të vendoset edhe nëse qëllimi i jashtëligjshëm i një shkeljeje nuk është arritur, pra ndërmarrjet në një marrëveshje të ndaluar do të gjobiten nëse ato kanë rënë dakord për fiksimin e çmimit, pavarësisht nëse niveli i fiksuar i çmimit është rritur apo jo deri në masën që dëshironin ato. Për këtë arsye ka dispozita ligjore dhe akte nënligjore që përcaktojnë sanksionet dhe procedurat e vendosjes së tyre.

Nëse një shkelje e rregullave të konkurrencës ka shkaktuar dëme te një palë e tretë, ligji parashikon mundësinë edhe të procedimit civil pranë gjykatave, ku të kërkohet dëmshpërblim nga ana e ndërmarrjeve që kanë shkelur ligjin.

Sanksionet Individuale

Legjislacioni shqiptar parashikon edhe raste të sanksioneve individuale kur shkelen dispozitat e ligjit 9121/2003. Kuadri ligjor i autoriteteve homologe, disa shkelje të rregullave të konkurrencës i kategorizon si vepra penale dhe shkelësit e ligjit rrezikojnë edhe dënimin me heqje lirie përveç sanksioneve me gjobë.



Njoftimet për shtyp dhe njoftimi mediatik

Vendimi i Komisionit të Konkurrencës sipas të cilit ndaj një ndërmarrjeje të caktuar janë vendosur sanksione administrative publikohet ne faqen zyrtare të Autoritetit, përmbledhet në një njoftim për shtyp dhe ka raste edhe njoftim mediatik.

Kjo do të sillte një ndikim të menjëhershëm ndaj emrit të mirë që një ndërmarrje mund të ketë vendosur në treg, cënim deri diku të reputacionit dhe imazhit dhe mbase edhe një tërheqje të klientëve, palëve të treta me të cilat bashkëpunon, deri edhe të konsumatorëve final të cilët mund të ndihen të mashtruar.

Gjithashtu, kryerja e procedurave hetimore nga AK, kërkojnë periudha të gjata kohore, kanë kostot e tyre financiare, njerëzore dhe kohë fizike. Në jo pak raste procedurat hetimore kërkojnë zhvillimin e diskutimeve të gjata dhe drejtorëve ekzekutivë u kushton shumë kohë, ndërkohë që ata do të preferonin të merreshin me aktivitetet e tyre të përditshme të biznesit.

Marrëveshjet e ndaluara ndërmjet ndërmarrjeve

Marrëveshjet anti-konkurruese ndërmjet ndërmarrjeve, të cilat, pavarësisht formës së tyre, kufizojnë lojën normale të konkurrentëve në treg, janë të ndaluara. Marrëveshje të tilla mund të marrin forma të ndryshme.

Edhe marrëveshjet joformale ndërmjet përfaqësuesve të ndërmarrjeve konsiderohen si joligjore.

Rastet më të rënda të këtyre lloj marrëveshjeve janë ato për fiksimin e çmimeve, ndarjen e tregjeve apo shpërndarjen e konsumatorëve, ndarjen e produkteve apo kufizimin e produkteve etj.

Të tilla praktika në shumicën e rasteve mbahen të fshehta dhe i referohen konkurrencës në treg. Këto sjellje hetohen nga AK dhe mund të rezultojnë në vendosjen e gjobave të rënda.

Shkëmbimi i informacioneve private ndërmjet ndërmarrjeve konkurruese lidhur me çmimet apo sasitë janë gjithashtu raste të shkeljeve të ligjit.

Çdo lloj shkëmbimi informacioni konfidencial dhe strategjik çon në shqetësime të konkurrencës në treg.

Në këtë rast bëhet fjalë për llojin e informacionit i cili ul pasigurinë në treg p.sh. lidhur me kostot e produktit, listat e klientëve, xhiron e realizueshme, kapacitetet, cilësitë, planet e marketingut etj.

Në disa raste edhe zbulimi i njëanshëm i informacioneve tregtare nga ana e një ndërmarrjeje me postë, e-mail, telefonata apo takime me konkurrentët e saj konsiderohet sjellje problematike.

Për t'u pasur parasysh nga ana e drejtorëve/administratorëve dhe punonjësve të ndërmarrjes kur kanë të bëjnë me konkurrentë në treg:

- **Nuk lejohet** fiksimi i çmimit të blerjes ose shitjes ose kushte të ndryshme tregtare;
- **Nuk lejohet** kufizimi i prodhimit, tregjeve, zhvillimit teknologjik apo investimeve;
- **Nuk lejohet** ndarja e tregjeve apo burimet e furnizimit;
- **Nuk lejohet** shkëmbimi i informacionit lidhur me çmimet apo sasitë ose informacion tjetër tregtar.

Duhet përmendur fakti se marrëveshjet ndërmjet konkurrentëve dhe ndërmarrjeve në nivele të ndryshme të zinxhirit shpërndarës mund të kenë efekte anti-konkurruese edhe

nëse ato nuk përmbajnë një nga kufizimet e mësipërme. P.sh. një marrëveshje mund të ketë ndikim negativ në një nga treguesit e konkurrencës si p.sh. çmimi, prodhimi, inovacioni apo cilësia e shumëllojshmërisë së të mirave dhe shërbimeve.



Abuzimi me pozitën dominuese

Nëse një ndërmarrje zotëron një pjesë të madhe në një treg të caktuar dhe është e aftë të veprojë në mënyrë të pavarur nga konkurrentët e tjerë, ajo me shumë të ngjarë ka një pozitë dominuese në këtë treg. Këto lloj ndërmarrjesh kanë përgjegjësi të veçanta për të mos u bërë pjesë e sjelljeve të cilat konsiderohen si abuzive. Ato mund të veprojnë në mënyrë të tillë që të kufizojnë konkurrentët nga konkurrenca efektive ose të synojnë t'i nxjerrin jashtë tregut.

Shembuj të sjelljeve abuzive janë vendosja e çmimeve tejet të larta jo të arsyetuara të cilat çojnë në shfrytëzim të klientëve; vendosja e çmimeve të ulta jo të arsyetuara të cilat çojnë në nxjerrjen e konkurrentëve nga tregu; praktika të pajustificuara diskriminuese ndërmjet klientëve; vendosja e kushteve tregtare të pajustificuara për partnerët e tyre të biznesit etj.

SME-të në çdo rast janë subjekt i ligjit të konkurrencës. Të qenët i vogël nuk do të thotë shmangie nga detyrimi për zbatimin e rregullave të konkurrencës.



Autoriteti i Konkurrencës

Autoriteti i Konkurrencës është institucioni përgjegjës për mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg dhe institucioni përgjegjës që siguron zbatimin e rregullave të konkurrencës. Ai heton shkelje të dyshuara dhe adreson vendime detyruese për ndërmarrjet me qëllim ndalimin e shkeljeve.

AK ka kompetencën e vendosjes së gjobave në rastet e shkeljes së ligjit. AK publikon një sërë udhëzimesh, broshurash informuese, përmbledhje vendimesh dhe informacione të tjera në faqen e tij zyrtare (www.caa.gov.al).



Si të sigurohet përpuethshmëria

Me qëllim që të sigurojnë një përpuethshmëri me rregullat e konkurrencës, ndërmarrjet duhet të mendojnë se si të hartojnë dhe zhvillojnë një program të dedikuar sipas situatës së tyre dhe jo reagim lidhur me problemet vetëm kur i hasin ato. Qëllimi është rritja e ndërgjegjësimit dhe njohurive mbi parimet e konkurrencës dhe shpërndarja e njohurive të përshtatshme se si të shmangët çdo sjellje anti-ligjore, njohuri që duhen shpërndarë që nga punonjësit e nivelit të ulët deri tek menaxherët e nivelit qendror.

Përpuethshmëri do të thotë që programi të jetë shpërndarë tek të gjitha hallkat e strukturës së ndërmarrjes dhe të jetë i qartë çdo element i tij.

Një strategji e suksesshme e një ndërmarrjeje do të bazohet në një analizë të fushave/rasteve në të cilat ka të ngjarë të rrezikohen apo të shkelen rregullat e konkurrencës. Këto varen nga faktorë të tillë si:

Sektori apo tregu ku ushtrohet aktiviteti ekonomik: p.sh. duke pasur parasysh raste të mëparshme të shkeljeve në këtë sektor/treg;

Niveli i ndërveprueshmërisë së ndërmarrjes me konkurrentët, p.sh. në një takim dedikuar një industrie të caktuar ose në takimet me shoqatat e biznesit por gjithashtu edhe në marrëveshjet tregtare të herëpashershme;

Karakteristikat e tregut, pozita e një ndërmarrjeje dhe konkurrentëve të saj, barrierat

e hyrjes etj. Nëse një ndërmarrje ka pozitë dominuese në treg, masat parandaluese që do të merren janë të ndryshme nga ato të një tregu, ku faktori risk është më shumë i lidhur me natyrën e një marrëveshjeje të ndaluar.

Paraqitja është një element rreziku i cili duhet marrë në konsideratë. Ky element varet nga pozita që ka çdo anëtar i stafit. Punonjësit, të cilët kanë përgjegjësi të caktuara dhe janë të ekspozuar p.sh. Punonjësit, të cilët shpesh ndërveprojnë me konkurrentët si pasojë e punës së tyre ose nëpërmjet pjesëmarrjes në dhomat e tregtisë, shoqatat e biznesit, apo bashkimet tregtare, duhet të kenë informacion të saktë dhe të qartë se çfarë duhet të kenë parasysh.

Program/Strategji e qartë

Përpuethshmëri do të thotë që programi të jetë shpërndarë tek të gjitha hallkat e strukturës së ndërmarrjes dhe të jetë i qartë çdo element i tij. Është e këshillueshme të jetë një program i shkruar qartë dhe saktë, dhe në gjuhën më të kuptueshme, të jenë sqaruar të gjitha terminologjitë dhe përkufizimet, madje edhe i ilustruar me raste në mënyrë që të kuptohet nga të gjithë. Mundet të jetë në formën e një manuali.

Një udhëzim i tillë i brendshëm mundet të përmbajë elementët kryesorë të ligjit të konkurrencës dhe të shpjegojë se si zbatohet ai, në mënyrë që të kuptohet sa më mirë dhe të jetë e qartë rëndësia e tij.

Duhet të mirëpërcaktohet një listë e veprimeve që nuk lejohen dhe shenja parandaluese si p.sh:

Nuk lejohen praktikant anti-ligjore të tilla si marrëveshjet për fiksimin e çmimeve, shkëmbimi i informacioneve mbi politikatat lidhur me çmimet, shpërndarja e kuotave mbi

prodhimin apo fiksimi i pjesëve të tregut, marrëveshjet në oferta në prokurimet publike, etj.

Shenja parandaluese lidhur me situata në të cilat mund të dyshohet se kemi shkelje të rregullave të konkurrencës. Këto mund të inkurajojnë administratorët dhe punonjësit që të tregojnë kujdes të veçantë nëse kërkojnë të shmangin ndonjë shkelje nga ana e ndërmarrjes së tyre.



Të testohet stafi me shkrim lidhur me zotërimin e njohurive dhe të informacionit përkatës lidhur me përpunshmërinë me rregullat e konkurrencës. Rekomandohen trajnime.

Në përshkrimet e vendeve të punës të vendosen pika lidhur me programin e përpunshmërisë.

Parashikimi i sanksioneve administrative të brendshme nga vetë ndërmarrja (në përputhje me Kodin e Punës dhe kuadrin ligjor në fuqi) në rast të shkeljes së programit të përpunshmërisë.

Zotime, të dukshme dhe afatgjata, për programet e përpunshmërisë nga ana e administratorëve

Pavarësisht nga zgjedhja e një strategjie/programi të drejtë dhe publikimit/aksesimit të tij nga i gjithë stafi, përfshirja direkt e niveleve menaxheriale është shumë e rëndësishme. Duhet të bëhet e qartë që përpunshmëria me ligjin dhe respektimi i tij duhet të jetë një nga politikat që zbaton ndërmarrja. Ky është një element thelbësor i krijimit të një kulture të respektimit të ligjit brenda ndërmarrjes. Caktimi i një personi përgjegjës në nivel administrativ i cili merr përsipër përgjegjësinë lidhur me përpunshmërinë është e këshillueshme me qëllim që të ndërmerren angazhime afatgjata për këtë objektiv.

Si të sigurohemi se stafi ka dijeni dhe njohuri për këtë program?

Disa nga masat që rekomandohen të merren nga ana e ndërmarrjeve mund të përfshijnë:

- **Të testohet stafi** lidhur me zotërimin e njohurive dhe të informacionit përkatës lidhur me përpunshmërinë me rregullat e konkurrencës. Rekomandohen trajnime.
- **Në përshkrimet e vendeve të punës** të vendosen pika lidhur me programin e përpunshmërisë.
- **Parashikimi i sanksioneve administrative** të brendshme nga vetë ndërmarrja (në përputhje me Kodin e Punës dhe kuadrin ligjor në fuqi) në rast të shkeljes së programit të përpunshmërisë.

Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme kanë avantazhin se udhëzimet që vijnë nga niveli lartë menaxherial drejt atij ekzekutiv poshtë janë më lehtë të zbatueshme duke qenë se numri i punonjësve është më i vogël. Në çdo rast, ajo që është e këshillueshme është caktimi i burimeve njerëzore të mjaftueshme, në përputhje me numrin e punonjësve të një ndërmarrjeje, me qëllim zotërimin e një programi përpunshmërie të besueshëm dhe të zbatueshëm.

Raportimi i brendshëm

Element shumë i rëndësishëm përveç pasjes dijeni është procesi i raportimit të rasteve kur mund të hasen elementë të shkeljes së ligjit të konkurrencës. Duhet që stafi i një ndërmarrjeje të mirëinformohet se te kush duhet të drejtohet dhe kë duhet të kontaktojnë nëse konstatojnë një rast konkret.

Rekomandohet caktimi i një personi përgjegjës, i cili raporton dhe informon direkt nivelet më të larta menaxheriale. Elementi kohë është shumë i rëndësishëm për vënien e menjëhershme në dijeni edhe të Autoritetit të Konkurrencës.

Nëse një punonjës ndodhet para faktit të një shkeljeje potenciale të rregullave të konkurrencës, programi duhet të përcaktojë hapat që duhet të ndiqen për të udhëzuar se si duhet të veprojnë dhe kush duhet të informohet.

Përditësim i vazhdueshëm, përcaktimi i pikave të kontaktit për këshillime dhe trajnime

Hartimi dhe miratimi i një programi/strategjie përpuethshmërie nuk mjafton.

Ajo çka është e rëndësishme është rishikimi i herëpashershëm, përditësimi dhe sidomos përcaktimi i një pike kontakti, i cili duhet të jetë i mirëinformuar dhe të këshillojë stafin lidhur me çdo dyshim mbi përpuethshmërinë dhe llojeve të ndryshme të sjelljes sipas rregullave të konkurrencës.

Trajnimi i stafit lidhur me rregullat e konkurrencës është element i rëndësishëm. Njihen praktika ku shumë biznese i ofrojnë stafit të tyre, sidomos të rinjve, seksione trajnuese, module trajnime ku çështje të veçanta i dedikohen respektimit të rregullave të konkurrencës.

Trajnime të vijueshme këshillohen për ata nëpunës të cilët mendohen se janë më pranë

pragut të të qenit të riskuar dhe që mund të përballen me këto situata, p.sh. personelit që merret me shitjet, përsa i përket politikave të vendosjes së çmimeve ndërmjet konkurrentëve.

Monitorimi dhe kontrolli

Monitorimi dhe kontrolli i vazhdueshëm shërben si një mjet për parandalimin dhe zbulimin e sjelljeve anti-konkurrese brenda ndërmarrjes, p.sh. duke verifikuar sjelljen e vetë ndërmarrjes gjatë procesit konkurrues në një procedurë prokurimi.

Kurse auditimi/kontrolli me prirjen të zbulojë këto sjellje anti-konkurrenciale vetëm pasi ajo ka ndodhur. Megjithatë është e këshillueshme një ndërthurje e të dyjave.

Programi synon që të parandalojë sjelljen anti-ligjore ose të minimizojë dhe të frenojë që në hapat e para një sjellje të tillë, si dhe i mundëson një ndërmarrjeje që të marrë hapat e duhura për parandalimin e një situatë të tillë.

Programi i Lehtësimit nga gjobat

Mekanizmat zbulues që ofron një program efektiv përpuethshmërie, ndihmojnë gjithashtu në funksionimin dhe zbatimin e Programit të Lehtësimit nga Gjobat. Praktika evropiane njeh raste kur disa nga marrëveshjet e ndaluara/kartelet me pasojë negative në treg janë zbuluar dhe ndaluar pikërisht si pasojë e zbatimit të politikave lehtësuese, si një mundësi për ndërmarrjet të cilat dëshirojnë kanë shfaqin

vullnetin të bashkëpunojnë me Autoritetin e Konkurrencës.

Informacioni i detajuar lidhur me Programin e Lehtësimit nga Gjobat gjenden në (http://www.caa.gov.al/uploads/laws/Programi_i_lehtesimit_nga_gjobat.pdf) si dhe formulari i aplikimit.

Konkluzione

Konkurrenca dhe Përpuethshmëria integron gamën e gjerë të mjeteve të shtrirjes, zbatimit dhe avokimit në një kornizë për nxitjen e konkurrencës dhe arritjen e pajtueshmërisë me kuadrin ligjor. Programi i përpuethshmërisë ndihmon komunitetin e biznesit që të mos sillen në kundërshtim me kuadrin ligjor në fushën e konkurrencës, si dhe rekomandon adresimin e rasteve të mospërputhjes për të nxitur konkurrencën në tregun shqiptar.

Programi i Përpuethshmërisë synon maksimizimin e përpuethshmërisë me aktet ligjore dhe nënligjore duke siguruar një treg konkurrues me përfitime të vazhdueshme për konsumatorët, bizneset dhe ekonominë shqiptare.

Zbulimi dhe parandalimi i shkeljeve të ligjit të konkurrencës mbetet fokusi kryesor i programeve të përpuethshmërisë. Qëllimi i një programi të përshtatshëm është të sigurojë që një ndërmarrje të veprojë sipas standardeve ligjore dhe etike. Një program i besueshëm i

përpuethshmërisë është një mjet i menaxhimit të rrezikut që ndihmon një ndërmarrje të arrijë këtë qëllim. Në të njëjtën kohë, AK inkurajon ndërmarrjet që të investojnë burimet e nevojshme për të pasur një program të besueshëm përpuethshmërie.

Programet e përpuethshmërisë duhet të hartohen sipas profilit të ndërmarrjeve, madhësisë, llojit të aktivitetit të biznesit dhe burimeve njerëzore të saj. Ekzistenca e një programi të tillë nuk është rrethanë lehtësuese apo e kundërta, në rastet e zbulimit të një shkeljeje të ligjit të konkurrencës.

Përgatitja dhe zbatimi i një program të pajtueshmërisë me ligjin e konkurrencës ka rezultuar i suksesshëm dhe me reagime pozitive nga ana e ndërmarrjeve që e kanë zbatuar atë. Ndërmarrjet ndërkombëtare të cilat kanë programet e tyre të përpuethshmërisë kanë rritur aspektet e sigurisë juridike, përfshirjen e personelit të tyre, imazhit publik, reputacionin dhe, si pasojë, kanë pasur përfitime të drejtpërdrejta në aspektin e zhvillimit tregtar të tyre.



I. Angazhimi: Të gjithë drejtuesit dhe menaxherët e nivelit të lartë duhet të marrin një angazhim të qartë, të dukshëm dhe personal për të bërë gjënë e duhur.

II. Identifikoni riskun: Duhet të kuptohet se vërtet mosrespektimi i parimeve të konkurrencës sjell pasoja. Një listë kontrolli është dhënë në vijim për t'ju ndihmuar të bëni këtë.

III. Zbutni rreziqet që mund të shfaqen. Disa sugjerime janë përmendur në vijim dhe ato duhet të dizajnohen për të minimizuar problemet që mund të shfaqen (p.sh. kontakte të konkurrentëve në panairë).

IV. Shtoni kontrollin: Përcaktoni saktë se si do të kontrolloni, në praktikë, se të gjithë ata që përfaqësojnë kompaninë tuaj veprojnë në përputhje me ligjin. Nëse është e nevojshme, përmirësoni politikat tuaja dhe kontrolloni aty ku shfaqen shqetësimet.

V. Ndiqni të njëjtën linjë: Rritni vazhdimisht angazhimin tuaj për të bërë gjënë e duhur; kështu, përpuethshmëria bëhet pjesë e mënyrës sesi kompania juaj bën biznes.



Pyesni veten

– **A** jeni i bindur se punonjësit tuaj e kuptojnë se diskutimi me konkurrentët tuaj mund të jetë sjellje joligjore (lidhur me çmimet, me volumet e shitjes apo blerjes, me target-konsumatorët dhe territoret ku ushtrohet aktiviteti)?

– **A** e dinë punonjësit tuaj se çfarë duhet të bëjnë nëse një konkurrent fillon një diskutim të tillë me ta? A u keni ofruar atyre udhëzime se si të sillen me konkurrentët?

– **Nëse** ju dërgoni njerëz në evente të sektorit të biznesit/industrisë ku ju jeni pjesë (takimet e shoqatave tregtare, konferencat ose ngjarjet shoqërore) jeni i bindur se ata dinë mjaftueshëm për zonat e riskut që të mos marrin pjesë në diskutime të papërshtatshme?

– **Mund** të tregoni se kompania juaj po mbron veten?





Check list!

Identifikimi i faktorëve të riskut:

NR	PYETJE	PO	JO
1	Takohen ndonjëherë/kontaktojnë përfaqësuesit e lartë të ndërmarrjes suaj me ata të ndërmarrjes konkurruese?		
2	Merrni pjesë në takime biznesi apo konferenca tregtare?		
3	Janë konkurrentët tuaj partnerë biznesi me ju?		
4	Keni krijuar <i>joint venture</i> me konkurrentët tuaj?		
5	Janë konkurrentët tuaj klientë apo furnitorë tuajt?		
6	Konkurroni ju me shpërndarësit tuaj?		
7	Në industrinë në të cilën jeni pjesë, lëvizin shpesh punonjësit nga një biznes në një biznes tjetër konkurrues?		
8	Kanë punonjësit tuaj informacion lidhur me çmimet e konkurrentëve apo planet e biznesit të tyre?		
9	Keni nënshkruar kontrata ekskluziviteti për periudha të gjata kohore me klientët apo furnitorët?		
10	Ka dispozita në kontratat tuaja lidhur me shitjen e përbashkët apo blerjen e përbashkët?		
11	Ka dispozita në kontratat tuaja lidhur me shkëmbimin e informacionit të ndjeshëm dhe konfidencial?		
12	Vendos biznesi juaj kufizime rishitjeje për shpërndarësit tuaj, agjentët apo klientët?		
13	A zotëron ndërmarrja juaj një pjesë të madhe të tregut në të cilin ju veproni?		

Si t'i reduktojmë këta faktorë risku?

Në botën reale, nuk ekziston "**zero risk**". Nëse ju jeni përgjigjur **po** në ndonjë nga pyetjet e mësipërme, është e nevojshme të rikontrolloni përgjigjet tuaja lidhur me risqet e mundshme të identikuara të konkurrencës.

Sugjerimet tona kryesore për një program të mirë përpuethshmërie janë renditur më poshtë:

1. Kush është përgjegjësi - Gjithkush brenda ndërmarrjes ka përgjegjësi të tij, pavarësisht se në jo pak raste përgjegjësia direkte qëndron kryesisht tek drejtuesit e ndërmarrjes. Sidoqoftë duhet që një ndërmarrje të ketë një person kontakti, në nivel menaxherial përgjegjës për respektimin e parimeve të konkurrencës. Caktoni një person në kompaninë tuaj si përgjegjës i informuar paraprakisht për rregullat që duhet të ndjekin. Drejtori i financave ose drejtori juridik mund të jetë një përshtatje e mirë, ose në një biznes më të vogël, mund të jetë një nga menaxherët e lartë.

2. Rreziqet dhe eliminimi i tyre - Përdorni informacionin publik lidhur me praktikën më të mira mbi programet e përpuethshmërisë me ligjin e konkurrencës. Ka shumë burime në Internet për t'u referuar!

3. Praktikë anti-ligjore - Siguroni që punonjësit tuaj të shmangin komunikimin me konkurrentët (qoftë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë) në lidhje me informacione të ndjeshme tregtare - të tilla si çmimi, ose planet dhe strategjitë konkurruese. Kujdes duhet tregtuar te përdorimi i konsulentëve që punojnë me konkurrentët - gjithmonë insistoni në ruajtjen e konfidencialitetit të informacionit tuaj të biznesit. Disa lloj veprimesh të tilla si diskutimet me konkurrentët nuk janë domosdoshmërisht një ide e mirë dhe janë me risk.

4. Trajnimi i punonjësve - Punonjësit që kanë kontakte me konkurrentët tuaj ose merren me shpërndarësit tuaj. Merrni në konsideratë caktimin e një trajnimi të thjeshtë ose udhëzimi për ta. Minimum i pritshëm është të siguroheni që ata të kuptojnë pritshmërinë tuaj lidhur me respektimin e ligjit. Rekomandohet të përdoret Informacioni që gjendet në faqen zyrtare të AK (www.caa.gov.al).

5. E fundit, (por jo e tillë për nga rëndësia) - Ndërmerrni hapat e duhur ligjorë nëse diçka do të shkonte keq. Është e rëndësishme të qëndroni të qetë dhe të ndërmerrni hapat e duhur për të mbrojtur ndërmarrjen dhe punonjësit tuaj.



Si të kontaktojmë Autoritetin e Konkurrencës

AUTORITETI I KONKURRENCËS

Website

www.caa.gov.al

Adresa

Rruga "Sami Frashëri" Nr. 4, Kati IV, Tirana, Albania
competition@caa.gov.al

Telephone

+355 4 2234 504



Kjo broshurë synon të rrisë aksesin dhe informacionin publik në lidhje me misionin dhe aktivitetin e Autoritetit të Konkurrencës. Broshura është informuese dhe nuk përmban këshilla ligjore.